



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVES

POLICISKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajvali - Prishtine



Nr. / Br. 04-052-589/2

Data / Datum 31.05.2021



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**

**RAPORT I INSPEKTIMIT TË JASHTËZAKONSHËM
“MENAXHIMI, FUNKSIONIMI DHE AKTIVITETET HETIMORE TË
DREJTORISË SË HETIMIT TË KRIMEVE EKONOMIKE DHE
KORRUPSIONIT”**

Nr. 4/2021

Prishtinë, 31 maj 2021

Informata të përgjithshme

Titulli	Raport i inspektimit të jashtëzakonshëm “Menaxhimi, funksionimi dhe aktivitetet hetimore të Drejtorisë së Hetimit të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit”
Data e përgatitjes	31 maj 2021
Përgatitur nga	Fitore Gajraku, Udhëheqëse e ekipit të inspektimit, Lenart Berisha, inspektor, Ragip Rexhepi, inspektor
Mbikëqyrur nga	Ilir Idrizaj, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv, Inspektorati Policor i Kosovës
Data e miratimit	31 maj 2021



1. Përmbledhja ekzekutive	
1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....	(4-5)
2. Hyrje	
2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....	(6-6)
2.2. Qëllimi i inspektimit.....	(6-6)
2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit.....	(6-6)
2.4. Objektivat e inspektimit.....	(6-6)
2.5. Rëndësia e inspektimit.....	(7-7)
2.6. Metodologjia e inspektimit.....	(7-7)
2.7. Periudha e realizimit dhe mbulimit të inspektimit.....	(7-7)
2.8. Drejtimit e inspektimit.....	(7-7)
2.9. Kriteret e vlerësimit.....	(7-7)
2.10. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....	(7-7)
3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet	
3.1 Organizimi, funksionimi dhe kapacitetet.....	(8-10)
3.2 Performanca në hetimin dhe zbulimin e krimit.....	(10-15)
3.3 Administrimi i dosjeve kriminale.....	(16-16)
4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve	
4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....	(17-18)

1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Lidhur me organizimin e brendshëm, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK) si subjekt i këtij inspektimi, ka funksionalizuar gjithë sektorët, por që për momentin, Njësia për Hetimin e Aseteve në kuadër të Sektorit për Hetime Financiare nuk ka staf për shkak të lëvizjes në njësitë tjera. Nuk ka një akt nënligjor që definon kompetencat lëndore në trajtimin e rasteve dhe në mungesë të dokumentit të tillë, janë hartuar dy Procedura Standarde të Operimit, njëra prej të cilave ka përcaktuar kompetencën lëndore deri në nivel të Drejtorisë¹, kurse tjetra përshkruan një ndarje të kompetencave për sektorët brenda Drejtorisë². Kjo e fundit nuk ka arritur të qartësojë sa duhet kompetencën lëndore për Sektorin e Njësisë Rajonale, në raport me sektorë tjerë të Drejtorisë. Drejtoria nuk ka të plotësuar në masën e duhur strukturën me burimet e nevojshme njerëzore, ngase ka personel të pamjaftueshëm në aspektin sasior (kuantitativ). Lidhur me sistemimin e personelit, brenda kapaciteteve ekzistuese janë identifikuar disa situata - raste të mospërputhjes gradë - pozitë.

1.1.2. DHKEK-ja pranon informata të shumta nga burime të ndryshme që denoncojnë krimin dhe varësisht nga besueshmëria e fakteve që ofrojnë ato, inicohen rastet penale. IPK vlerëson se duhet rishikuar procedura aktuale e trajtimit të informatave, regjistrimit të tyre dhe mbajtjes së shënimeve zyrtare lidhur me to. Kontrolli i regjistrave mbi evidencat nxjerrë në pah se ka nevojë të eliminohen disa dobësi që lidhen me vendosjen e të dhënave mbi lëndët, të cilat me një përkushtim të ngritur do të mund të sanohen. Numri i informatave të siguruara nga burime të ndryshme ka rënë në masë të madhe përgjatë vitit 2020 krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2019, rreth 75% e informatave ka rezultuar me inicim të rasteve, derisa në vitin 2020, kjo shifër sillet në 39%. Viti 2020 shënon rënie dhe të numrit të rasteve të iniciuara për 69% krahasuar me një vit më parë. Nëse krahasojmë numrin e rasteve të administruara me numrin e rasteve të zbuluara, gjatë vitit 2020 është shënuar një trend negativ i përcjellur me një rënie të zbulueshmërisë së rasteve në kuadër të Drejtorisë nga 92% sa ishte për vitin 2019, në 80% për vitin 2020. Nëse marrim parasysh numrin e përgjithshëm të rasteve të iniciuara brenda vitit dhe atyre të bartura nga vitet paraprake, raporti ndërmjet rasteve të zbuluara (të zgjidhura apo të mbyllura) dhe atyre të pazbuluara për vitin 2019 qëndron në kuotat 92% : 8%, derisa në vitin 2020 ky raport sillet në kuotat 80% : 20%. Numri i rasteve të bartura nga viti 2019 në 2020, paraqet 7% të numrit të përgjithshëm të rasteve të administruara, derisa numri i rasteve të bartura nga viti 2020 në 2021, paraqet 18% të numrit të përgjithshëm të rasteve të administruara.

1.1.3. Nga kontrolli i dosjeve hetimore del se shumica prej tyre nuk kanë pasur raporte policore njoftuese për Prokurorin e Shtetit, të cilat duhet t'i dorëzohen këtij autoriteti brenda 24 orëve nga momenti kur Policia ka dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare. DHKEK përdorë formularët standard si pjesë e dosjes hetimore, të harmonizuara me aktet ligjore në fuqi. Deklaratat e marrjes në pyetje dëshmojnë se respektohen të drejtat e të dyshuarve në procedurë paraprake dhe nga kontrolli i dosjeve del se para marrjes në pyetje të të dyshuarve apo dëshmitarëve, u lexohen paralajmërimet mbi të drejtat e rezervuara. Duhet shtuar kujdes që të eliminohen dobësitë ku në disa raste, të intervistuarit nënshkruajnë në pjesë të formularit ku ndahet

¹ Procedura Standarde e Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore e hetimit (DPPK-01/04/5/2020).

² Procedura Standarde e Operimit për Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit (06/1-02/47-2018).

hapësira për nënshkrim të intervistuesit. Kallëzimet penale pavarësisht faktit që nuk kanë formë të veçantë të hartimit, plotësojnë kriteret themelore dhe janë hartuar në nivel të kënaqshëm, dhe janë të nënshkruara nga mbikëqyrësit dhe hetuesit që i kanë ushtruar. Asnjëra nga dosjet e kontrolluara nuk ka përmbajtur planet e veprimit, të cilat do të duhej nxjerrur në bashkëpunim me mbikëqyrësit, sipas të cilave do të zhvilloheshin proceset hetimore, ashtu siç parashihet me procedurat standarde në fuqi. Nga dosjet e kontrolluara, është vlerësuar se dispozitat ligjore për të drejtën në mbrojtje janë zbatuar në harmoni me nenin 57 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). DHKEK ka në funksion Dhomën e dosjeve hetimore për lëndët që mbahen në pronësi të fond-krijuesit (Drejtorisë), deri në momentin kur konsiderohen si lëndë të përfunduara. Dhoma e dosjeve penale ka nevojë të avansojë kushtet nën të cilat duhet ruajtur dosjet hetimore, meqë nuk garanton mbrojtje të sigurtë të tyre. Dosjet hetimore janë sistemuar e klasifikuar në një hapësirë të mjaftueshme. Për nevoja të sigurisë së dosjeve hetimore dhe ngritjes së efektivitetit në punë, nevojitet të konsolidohet evidenca mbi praninë e dosjeve në Dhomë dhe asaj të hyrje - daljeve në hapësirat ku mbahen ato.

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Polici, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë për të siguruar një shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Bazuar në legjislacionin aktual, veç inspektimeve që iniciohen bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta, IPK zhvillon dhe inspektime të jashtëzakonshme që mund të rrjedhin si kërkesë e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Ministrit të Punëve të Brendshme. Bazuar në këtë, me datë 31 mars 2021, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së ka kërkuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar aktivitetet hetimore, funksionimin dhe menaxhimin e Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK). Ky inicim ka ardhur me kërkesë të Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla, të datës 30 mars 2021. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet fushë me interes për IPK-në me qëllim që të vlerësoj nëse Drejtoria ka strukturë funksionale me kapacitete të mjaftueshme teknike dhe njerëzore për hetimin dhe zbulimin e krimit, ka nxjerrë dhe zbatuar bazën ligjore dhe strategjike të nevojshme për të ulur trendet e krimit, si dhe është përfshirë seriozisht me përkushtim në përmbushjen e objektivave në forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit në vend.

2.2. Qëllimi i inspektimit

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret, parimet e procedurat policore zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet;
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat policore;
- Që të jepet opinion objektiv mbi çështjet lidhur me menaxhimin e burimeve, aktiviteteve operative dhe hetimore;
- Që të identifikojë mangësitë - dobësitë dhe rekomandoj masa për funksionim më të mirë;
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës në fushat përkatëse.

2.3. Objekti dhe subjekti i inspektimit

2.3.1. Në këtë inspektim të jashtëzakonshëm është vlerësuar menaxhimi, funksionimi e aktivitetet hetimore të Drejtorisë së Hetimit të Krimeve Ekonomike e Korrupsionit. Subjekti i inspektimit ka qenë Drejtoria e Hetimit të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Departamentin e Hetimeve.

2.4. Objektivat e inspektimit

2.4.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Të vlerësohet organizimi, funksionimi dhe kapacitetet;
- Të vlerësohet performanca e DHKEK-së në hetimin dhe zbulimin e krimeve;
- Të vlerësohet administrimi i dosjeve (ruajtja dhe arkivimi).

2.5. Rëndësia e inspektimit

2.5.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ngritjen e efikasitetit të njësive hetimore për luftimin dhe zbulimin e krimit;
- Ngritjen e performancës për hetimin e krimit dhe administrimin e rasteve.

2.6. Metodologjia e inspektimit

2.6.1. Gjatë inspektimit:

- a) janë zhvilluar takime - intervista me bartës funksionesh dhe përgjegjës të strukturës, si: Drejtorin e Drejtorisë, Zyrtarin e Administrimit të Rasteve dhe hetuesit e rasteve;
- b) janë kryer këqyrje - verifikime të kushteve të punës, të administrimit të dosjeve penale, të kushteve teknike dhe sigurisë në arkiv, si dhe librave të evidencave dhe dosjeve;
- c) janë siguruar dhe marrë: kopje të raporteve vjetore të punës, baza ligjore që rregullon aktivitetet dhe detyrat në këtë Drejtori, kopje të dosjeve penale për lëndët e proceduara me kallëzim penal dhe me raporte të veçanta (tre dosje me kallëzime penale dhe tre tjera me raport të veçantë).

2.7. Periudha e realizimit të inspektimit

2.7.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datën 01.04.2021 dhe ka përfunduar me datë 03.04.2021, por verifikimet e nevojshme të dokumentacionit kanë vazhduar edhe ditëve në vijim.

2.8. Drejtimit e inspektimit

2.8.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Organizimi, funksionimi dhe kapacitetet,
- Aktivitetet operative dhe hetimore,
- Mirëmbajtja e dosjeve penale.

2.9. Kriteret (standardet) e vlerësimit

2.9.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave policore:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale;
- Ligji i Policisë;
- Procedura Standarde e Operimit për DHKEK;
- Procedura Standarde e Operimit për menaxhimin e dokumenteve arkivore;
- Strategjitë nacionale dhe ato policore për luftimin e krimit;
- Dokumentet tjera relevante që rregullojnë fushën e hetimeve.

2.10. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave

2.10.1. IPK vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës inspektuese.

3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Organizimi, funksionimi dhe kapacitetet

3.1.1. Bazuar në Strukturën organizative të datës 28.02.2019, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit është e strukturuar në kuadër të Departamentit të Hetimeve të Policisë së Kosovës. Kjo Drejtori është e organizuar në katër (4) sektorë: Sektori i Njësive Rajonale, Sektori për Hetimin e Krimeve Ekonomike, Sektori për Hetimin e Korrupsionit, si dhe Sektori për Hetime Financiare. Në kuadër të Sektorit të Njësive Rajonale janë të shpërndara tetë njësi hetimore që janë nën ombrellën e Drejtorisë. DHKEK ka arritur të funksionalizoj të gjithë sektorët dhe njësitë, por njëra nga ato (Njësia për Hetimin e Aseteve në kuadër të Sektorit për Hetime Financiare) nuk ka personel të angazhuar, përshkak të lëvizjes së stafit nëpër njësi të tjera. Policia duhet të angazhohet në funksionalizimin e plotë të sektorëve dhe njësive, siç parashihet me strukturimin e brendshëm organizativ.

3.1.2. E interesuar të njihet me ndarjen e kompetencës lëndore ndërmjet sektorëve, me fokus për Sektorin e Njësive Rajonale në raport me sektorët tjerë qendror, IPK nuk ka hasur në akt nënligjor që rregullon dhe përcakton kompetencën lëndore për sektorët e tillë. Policia ka synuar që këtë vakuum (boshllëk) ta bëjë me procedura standarde të operimit. Procedura Standarde e Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetenca lëndore e hetimit (DPPK-01/04/5/2020, e datës 25.08.2020) përcakton kompetencën lëndore deri në nivel të Drejtorisë. Kompetencat për sektorët në kuadër të Drejtorisë janë përcaktuar me Procedurë Standarde të Operimit për Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit (06/1-02/47-2018, datë 21 qershor 2018). Sipas kësaj PSO-je, në pikat 7.3, 9.12, 9.13, 9.14 dhe 9.15, trajtohet kompetenca lëndore për sektorët e Drejtorisë. Mirëpo, detyrat e sektorëve të nivelit qendror nuk janë ndarë qartazi me ato të Sektorit të Njësive Rajonale, pasi që sipas PSO-së edhe Sektori i Njësive Rajonale dhe sektorët tjerë të nivelit qendror trajtojnë veprat e njëjta brenda fushëveprimit të DHKEK-së. Në mungesë të definimit të qartë të këtyre kompetencave, PSO i ka dhënë të drejtën Drejtorit të Drejtorisë për të vendosur se nga cili nivel do të trajtohen rastet. IPK-ja vlerëson se mosaktimi i kompetencave lëndore shkakton paqartësi për trajtimin e rasteve dhe kjo mbetet që për çdo rast të vendosë Drejtori i DHKEK-së për nivelet e trajtimit të tyre.

Rekomandimi nr. 1

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit, që të sigurohet se janë ndarë qartë kompetencat lëndore të njësive rajonale në raport me sektorët tjerë qendror të Drejtorisë, në drejtim të eliminimit të paqartësive se kush duhet të merret me trajtimin e lëndëve dhe kjo minimizon situatat që Drejtorit t'i njihet ekskluziviteti në ndarjen e rasteve (lëndëve).

3.1.3. Bazuar në Strukturën organizative (28.02.2019), kapacitetet e planifikuara të burimeve njerëzore përfshijnë gjithsej 114 punonjës. IPK-ja është interesuar të njihet nga afër me kapacitetet aktuale të burimeve njerëzore të Drejtorisë dhe vërehet që ato nuk janë të plota, meqë Drejtoria ballafaqohet më mungesë burimesh njerëzore. Nëse krahasojmë gjendjen e përgjithshme sasiore të burimeve aktuale me ato të planifikuara, vihet në pah se kjo Drejtori ka të plotësuar numrin e vendeve të punës në kuotën prej 85%. Vërehet mungesë e një numri të madh zyrtarësh policor në cilësi të hetuesve. Lidhur me sistemimin e personelit, në kuadër të Drejtorisë janë hasur situata të

mospërputhjes gradë - pozitë. Janë evidentuar 15 raste kur punonjës të graduar nuk janë sistemuar në pozita që parashihen të ushtrohen nga grada përkatëse. Një major ushtron detyrën në pozitën e Drejtorit të DHKEK-së, e cila pozitë parashihet të ushtrohet nga një punonjës me gradë më të lartë (nënkolonel). Ndërsa, 14 rreshterë ushtrojnë detyrat në pozita, që parashihen të ushtrohen nga punonjës me grada më të ulëta (zyrtar policor)³. Një shërbyes civil është hasur i pasistemuar, ngase në kohën e verifikimit, i njëjti ishte transferuar për nevoja operative pa vendim mbi caktimin në detyrë. IPK-ja vlerëson se Policia duhet të përpiqet që të minimizoj mospërputhjet mes gradës dhe pozitës, duke bërë sistemimin e personelit në pajtim me kushtet dhe kriteret për çdo vend pune. Sektori për Hetimin e Krimeve Ekonomike nuk ka udhëheqës dhe në mungesë të tij, udhëheqësit e dy njësisive në kuadër të sektorit raportojnë në vijë vertikale dy shkallë më lartë, direkt tek Drejtori.

Tabela nr. 1- Të dhëna mbi burimet njerëzore të planifikuara dhe aktuale të DHKEK (prill 2021)					
Grada	Burimet njerëzore			Mospërputhje gradë - pozitë	
	Numri i paraparë	Numri aktual	Ndryshimi	Grada më e ulët se pozita	Grada më e lartë se pozita
Kolonel	0	0	0	0	0
Nënkolonel	1	0	-1	1	0
Major	1	2	+1	0	0
Kapiten	4	3	-1	0	0
Toger	12	12	0	0	0
Rreshter	22	36	+14	0	14
Polic	69	39	-30	0	0
Staf Civil	5	5	0	0	0
Gjithsej	114	97⁴	-17	1	14

3.1.4. Për të përmbushur nevojat e Drejtorisë me burimet e nevojshme njerëzore dhe në të njëjtën kohë që të vihet në zbatim struktura organizative, Drejtori i DHKEK ka kërkuar hapjen e konkursit për plotësimin e disa prej vendeve të lira të punës⁵. Duke pasur parasysh situatën me shpërndarjen e personelit brenda Drejtorisë dhe mospërputhjet pozitë - gradë, kërkesa e paraqitur nuk ka qenë e analizuar mirë dhe konform burimeve të planifikuara e atyre ekzistuese që rrjedhin nga struktura organizative. Duke u bazuar në kërkesën e prezantuar, udhëheqësi i kësaj Drejtorie ka parashtruar kërkesë e cila nuk balancon në tërësi sistemimin e duhur të graduarve dhe punonjësve brenda kësaj Drejtorie. Kërkesa është parashtruar për të shtuar numrin e togerëve edhe për një (1) sish, me gjithë faktin se struktura është e përmbushur me punonjës të kësaj grade. Po ashtu, kërkesa përfshinë shtimin e strukturës edhe për pesë (5) rreshterë, përkundër faktit që numri i tyre tejkalon atë të përcaktuar (është i njohur fakti se 14 rreshterë ushtrojnë pozita që parashihen të ushtrohen nga punonjës me grada më të ulëta). Përkundër kësaj, nuk është hasur në kërkesë për plotësimin e pozitave të lira, siç është rasti për një (1) kapiten dhe zyrtarët policor hetues që në numër të konsiderueshëm janë mangu. Pas kërkesës të Drejtorit të DHKEK-së për hapjen e konkursit për plotësimin e vendeve të lira, Departamenti për Burime Njerëzore, më 06.04.2021 ka hapur konkurs për një (1) toger, pesë (5) rreshterë dhe tetë (8) pozita për hetues.

³ Mospërputhja pozitë - gradë që lidhet me 14 rreshterët që kryejnë detyrat e hetuesve, është gjendje e trashëguar dhe paraqet problematikë tash e një kohë. Vlerësohet se kjo gjendje duhet sanuar me ndryshime në strukturën organizative.

⁴ Në këtë numër përfshihen edhe pesë (5) punonjës nën masë administrative (suspendim i përkohshëm) të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, me rekomandimin e IPK-së, dhe një (1) punonjës policor, i cili për shkak të procesit hetimor është i transferuar përkohësisht jashtë Drejtorisë.

⁵ Kërkesë për hapje të konkursit për plotësimin e vendeve të lira në DHKEK (datë 11.02.2021, ref. 06/1-02/009-2021).

Rekomandimi nr. 2

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit, që në koordinim me Departamentin e Burimeve Njerëzore, të shqyrtojnë situatën aktuale me burimet e disponueshme dhe ato të nevojshme, në mënyrë që kërkesat për plotësimin e vendeve të punës të jenë të bazuara në Strukturën organizative, duke eliminuar mospërputhjet gradë-pozitë dhe sistemuar personelin konform nevojave.

3.2. Performanca në hetimin dhe zbulimin e krimit

3.2.1. Rastet që hetohen nga sektorët dhe njësitë e DHKEK-së, përpos që inicohen drejtpërdrejtë nga vendngjarja, mund të inicohen edhe përmes të rrugëve tjera ligjore, nga informatat e ndryshme dhe me kërkesë të Prokurorit të Shtetit. Informatat mund të merren në mënyrë të shkruar fizike, apo elektronike, dhe të drejtuara nga institucione të ndryshme qeveritare, joqeveritare, organizata të ndryshme, biznese, kompani e qytetarë të identifikuar apo anonim. Sipas PSO-së për Drejtorinë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit, “çdo person që paraqitet fizikisht në DHKEK në nivel qendror për të raportuar një rast, do të dërgohet te Drejtori i DHKEK, apo i deleguari i tij, për të zhvilluar një bisedë informative, i cili do të vendosë nëse rasti do të hetohet nga DHKEK, apo personi do të udhëzohet për ta paraqitur çështjen e tij në institucione tjera apo procedura tjera ligjore, kur personi paraqitet në nivel rajonal, të njëjtën procedurë do ta zhvillojë shefi i njësisë apo i deleguari i tij”. IPK vlerëson se kjo nuk është mënyra më e përshtatshme e trajtimit të palës, që ai paraprakisht të dërgohet tek Drejtori apo i deleguari i tij për bisedë informative. Çdo palë që paraqitet në DHKEK duhet paraprakisht të regjistrohet dhe të bëhet një shënim zyrtar për palën që është paraqitur. Deklarata e palës mund të merret në formë të intervistës, duke bashkëbiseduar me qëllim të mbledhjes së të dhënave për rastin konkret.

Rekomandimi nr. 3

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit, që të rishikoj politikat aktuale të trajtimit të informatave, duke synuar ndryshimin - plotësimin e Procedurave Standarde të Operimit, në mënyrë që të rregullohet procedura mbi pranimin e palës, regjistrimin paraprak të tij dhe mbajtjen e shënimit zyrtar mbi rastin që raportohet.

3.2.2. Pas pranimit të informatës për një veprë të dyshuar penale që hetohet në DHKEK (në nivel të njësisë rajonale apo qendrore), duhet të dorëzohet tek Drejtori i DHKEK apo i emëruari i tij dhe pas shqyrtimit dhe analizimit vendoset se si të bëhet procedimi i saj i mëtejshëm. Pas regjistrimit të informatës në librin përkatës nga shefi i sektorit apo shefi i njësisë, caktohet hetuesi përgjegjës, i cili do të kryejë veprime hetimore paraprake bazuar në KPP, nëse ka dyshim të arsyeshëm që një veprë penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare të jetë kryer. Pas veprimeve paraprake, brenda 24 orëve njoftohet Prokurori i Shtetit dhe varësisht udhëzimeve e autorizimeve të tij, rasti procedohet sipas dispozitave të KPP-së. DHKEK duhet të regjistrojë në libra përkatës, të gjitha informatat mbi rastet penale, si dhe shkresat hyrëse - dalëse. Libri i regjistrimit të rasteve mbahet nga shefat e sektorëve dhe të njësisë rajonale. Inspektorët kanë kontrolluar librat dhe kanë vërejtur se mbahen në përputhje me PSO-në. Libri i regjistrimeve të informatave mbahet nga Njësia e Analizës dhe Statistikave, shefat e sektorëve dhe të njësisë rajonale. Në Librin e regjistrimit të informatave nuk kanë qenë të plotësuar të gjitha shënimet siç parashihet me PSO (është hasur që në vend të numrit rendor është shkruar numri i rastit dhe ka mungesë të nënshkrimit të pranuesit). Libri i regjistrimit të kërkesave nga Prokuroria e Shtetit mbahet nga Njësia e Analizës e Statistikave, shefat e sektorëve

dhe njësisve rajonale. IPK-ja vë në pah se në disa raste mungon nënshkrimi i pranuesit dhe në vend të numrit rendor është shkruar numri i rastit. IPK-ja nxitë personat përgjegjës për mbajtjen e këtyre evidencave, që të shtojnë kujdesin në mbajtjen e duhur të librave.

3.2.3. DHKEK zhvillon aktivitete të ndryshme operative - hetimore për të parandaluar aktivitetin kriminal, për të kapur të dyshuarit dhe për të identifikuar rrugët, përmes të cilave kryhen veprat kriminale. IPK është interesuar për të matur performancën e Drejtorisë për dy vitet e fundit duke i kushtuar rëndësi përpunimit të informatave të pranuar nga burimet e ndryshme, inicimit të rasteve dhe ngarkesës së hetuesve. Në vitin 2019, rreth 75% e informatave të pranuar kanë rezultuar me inicim të rasteve penale (një hetues i Drejtorisë është ngarkuar mesatarisht me 7 raste brenda vitit). Ndërsa, në vitin 2020, rreth 39% e informatave të pranuar kanë rezultuar me inicim të rasteve të reja penale (një hetues është ngarkuar mesatarisht me 2.2 raste brenda vitit). Nëse i krahasojmë të dhënat mbi trendët e viteve të fundit, gjatë vitit 2020 kemi rënie prej 41% të numrit të informatave të pranuar nga Drejtoria. Kemi rënie për 69% edhe të numrit të rasteve të hapura, si vepra penale në kompetencë të DHKEK-së. Bazuar në këta parametra, gjatë vitit 2020 ka shënuar rënie edhe ngarkesa e hetuesve me raste, nga 7 në 2.2 raste në vit për një hetues. Në bazë të informatave të siguruar nga intervistat me zyrtarë përgjegjës të Drejtorisë, deri tek rënia e numrit të informatave dhe iniciemeve të rasteve ka ardhur për shkak të ndikimit të pandemisë dhe përfshirjes së personelit në planet operative për monitorimin e zbatimit të masave kundër Covid-19.

Tabela nr. 2 - Indikatorët e performancës mbi numrin e informatave, rasteve të reja të hapura dhe ngarkesës së hetuesve në administrimin e rasteve (2019/2020)

Drejtoria	Numri i informatave		Numri i rasteve të hapura ⁶		Përqindja (%)		Numri i hetuesve		Ngarkesa me raste	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
DHKEK	838	492	625	192	75%	39%	89	89	7.0	2.2

3.2.4. Plani Strategjik Zhvillimor (2016-2020) i ka vënë objektiv specifik Policisë, "përmirësimin e ruajtjen e sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e aktiviteteve kriminale", në kuadër të të cilit objektiv parashihen aktivitete për zvogëlimin e rasteve kriminale e ngritjen e zbulueshmërisë. Shkalla e zbulueshmërisë së rasteve⁷ dhe efikasiteti i njësisve hetimore është problematike për t'u vlerësuar nga IPK për faktin se rastet e përfunduara me kallëzime penale në Prokurori, domosdo nuk përfundojnë me ngritje të aktakuzave apo dënimin e kryesve të veprave penale. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet totali i rasteve të administruara, përfshirë dhe rastet e bartura nga vitet paraprake, të cilat ngarkojnë volumin e angazhimit për hetuesit (nga viti 2018 janë bartur 40 raste në vitin 2019, gjersa nga viti 2019 janë bartur 45 raste në vitin 2020). Numri i rasteve të bartura nga viti 2019 në vitin 2020, paraqet 19% të numrit të përgjithshëm të rasteve të administruara nga Drejtoria (një nga pesë raste të administruara është bartur në vitin pasues). Nëse krahasojmë numrin e rasteve të administruara me numrin e rasteve të zbuluara, gjatë vitit 2020 është shënuar trend negativ i përcjellur me rënie të zbulueshmërisë së rasteve në kuadër të Drejtorisë nga 92% sa ishte për vitin 2019, në 80% për vitin 2020. IPK-ja ka analizuar trendin e zhvillimit dhe luftimit

⁶ Në këto shifra përfshihen rastet e inicuar brenda vitit përkatës dhe rastet e pranuar nga njësitë tjera (në këto shifra nuk përfshihen rastet e bartura nga vitet paraprake).

⁷ Sipas praktikave policore të pasqyrimin të rezultateteve të hetimeve, rastet e dërguara në Prokurori me kallëzime penale me kryes të njohur dhe raporte të veçanta konsiderohen si raste të zbuluara, kurse të pazbuluara konsiderohen rastet me kallëzime penale me persona NN dhe rastet e mbetura në hetim.

të krimit, zbulueshmërinë e veprave penale dhe efikasitetin e Drejtorisë në trajtimin e rasteve të inicuar brenda vitit kalendarik dhe të atyre të bartura nga vitet paraprake. Nga analiza e ngarkesës së hetuesve me raste, gjatë vitit 2019 përgjithësisht një hetues i kësaj Drejtorie ka administruar mesatarisht 7.4 raste, përfshirë edhe ato të bartura, derisa në vitin 2020, kjo ngarkesë bie në 2.6 raste. Mesatarisht 6.8 raste të zbuluara pasqyrohen si ngarkesë për një hetues i Drejtorisë brenda vitit 2019, derisa në vitin 2020 kjo ngarkesë sillet në 2.1 raste⁸.

Tabela nr. 3 - Trendet e kriminalitetit dhe indikatorët e performances dhe efikasitetit të DHKEK

Drejtori	Numri i rasteve		Raste të zbuluara		Ngarkesa për polic		Të zbuluara për hetues		Kuota e zbulueshmërisë	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
DHKEK	665	237	612	189	7.4	2.6	6.8	2.1	92%	80%

3.2.5. Inspektorët kanë analizuar rezultatin e hetimeve për rastet e hapura brenda vitit përkatës dhe për ato të bartura. Nëse marrim parasysh numrin e përgjithshëm të rasteve të inicuar brenda vitit dhe atyre të bartura nga vitet paraprake, raporti ndërmjet rasteve të zbuluara (të zgjidhura apo të mbyllura) dhe atyre të pazbuluara për vitin 2019 qëndron në kuotat 92% : 8%, derisa në vitin 2020 ky raport sillet në kuotat 80% : 20%. Nga të dhënat del se në vitin 2019 kur numri i rasteve ka qenë më i lartë, po ashtu e lartë ka qenë edhe përqindja e numrit të rasteve të zbuluara. Kurse, në vitin 2020 edhe pse numri i rasteve ka qenë më i ulët, përqindja e numrit të rasteve të zbuluara ka pësuar rënie. Përveç kësaj, inspektorët kanë analizuar edhe statusin e rasteve varësisht nga ajo se a kanë qenë të hapura brenda vitit apo kanë qenë të bartura. Kur i referohemi statusit vetëm për rastet e inicuar brenda vitit, raporti ndërmjet rasteve të zbuluara dhe atyre të pazbuluara në vitin 2019 qëndron në kuotat 92% : 8%, kurse në vitin 2020 lëviz në kuotat 77% : 23%. Në anën tjetër, kur i referohemi statusit vetëm për rastet e bartura, kuotat mbesin të njëjta për dy vitet, 93% : 7%. Nga këta parametra del se në vitin 2020 përqindja e numrit të rasteve të zbuluara nga kategoria e rasteve të inicuar brenda vitit përkatës ka shënuar një rënie krahasuar me një vit më parë.

Tabela nr. 4 - Analizë mbi statusin e rasteve dhe zbulueshmërinë sipas viteve 2019-2020

Rezultati hetimor (statusi)	Viti 2019		Gjithsej	Viti 2020		Gjithsej
	Raste të vitit	Të bartura		Raste të vitit	Të bartura	
Kallëzime me kryes të njohur	518	27	545	138	19	157
Raporte të veçanta	57	10	67	9	23	32
Kallëzime penale me persona NN	6	2	8	4	2	6
Të mbetur në hetim për vitin pasues	44	1	45	41	1	42
Totali	625	40	665	192	45	237

3.2.6. Numri i lëndëve të bartura nga vitet paraprake në vitet pasuese mbetet afërsisht i njëjtë. Numri i rasteve të bartura nga viti 2019 në 2020 paraqet 7% të numrit të përgjithshëm të rasteve të administruara nga Drejtoria (44 raste të inicuar brenda vitit 2019 dhe 1 rast i bartur nga viti 2018), derisa numri i rasteve të bartura nga viti 2020 në vitin 2021 paraqet 18% të numrit të përgjithshëm të rasteve të administruara (41 raste të inicuar brenda vitit 2020 dhe 1 rast i bartur

⁸ Kjo matje përfshinë vetëm matjet lidhur me rastet e hapura për hetim, por jo edhe për aktivitetet tjera që mund të realizohen varësisht nga kërkesat tjera, përfshirë edhe ato të Prokurorisë së Shtetit.

nga viti 2019). Nga kjo del se në vitin 2020, secili hetues i Drejtorisë është ngarkuar mesatarisht edhe me 0.51% të lëndëve nga viti paraprak, derisa në vitin 2021 kjo ngarkesë është 0.48% (afërsisht një rast për dy hetues).

3.2.7. Policia është një organ shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga krimi, mbajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, si dhe sigurimin e rendit të caktuar shtetëror. Puna policore në masë të madhe lidhet me parandalimin, hetimin dhe zbulimin e krimit, prandaj Policia ndërmerr veprime hetimore, si dhe masa të nevojshme që të zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre, që të grumbulloj informata të nevojshme për vendndodhjen e kryesve të tyre, të zbuloj dhe ruaj gjurmët dhe provat që kontribuojnë në zbardhjen e kryesve të veprave penale dhe të mbledhë informatat e nevojshme për paraqitje në procedurën penale. Për t'iu kundërvënë me sukses krimit, Policia ndërmerr një varg aktivitete policore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Për të vlerësuar respektimin e rregullave dhe procedurave hetimore në DHKEK, IPK-ja ka siguruar dhe kontrolluar gjashtë (6) dosje penale të proceduara në Prokuroritë kompetente me kallëzime penale apo me raporte të veçanta, me të cilat njoftohet Prokurori i Shtetit për veprat penale dhe kryesit e tyre. Në kuadër të këtyre rasteve është vlerësuar rregullsia e lëndëve penale, nëse përmbajnë dokumentet e formularët e nevojshëm që kanë të bëjnë me hetimin dhe dokumentimin e krimit. Është verifikuar respektimi i disa prej veprimeve paraprake hetimore dhe përdorimi i formularëve të standardizuar brenda rasteve.

3.2.8. Në kuadër të kriterëve të përcaktuara për kontrollin e dosjeve është vlerësuar prezenca e Raportit policor brenda dosjes, që i drejtohet Prokurorit kompetent për njoftim mbi dyshimin e arsyeshëm se është kryer vepra penale. Bazuar në dispozitën ligjore të Kodit të Procedurës Penale, neni 70, paragrafi 4, posa Policia të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer një vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, është e detyruar që brenda 24 orëve t'i dorëzojë një raport policor Prokurorit të Shtetit që është kompetent, i cili pastaj vendos nëse duhet filluar procedurë penale". Pesë (5) nga gjashtë (6) dosjet hetimore të kontrolluara, nuk kanë pasur Raport policor njoftues për Prokurorin⁹. Në këtë mënyrë, zyrtarët policorë hetues në këto raste nuk e kanë përfillur nenin 70 të KPP-së. Mungesa e raportit me shkrim në një pjesë të rasteve nga ana e zyrtarëve policor për Prokurorinë e Shtetit, të paraparë në nenin 70 të KPP-së, vjen nga neglizhenca e hetuesve për të hartuar raporte mbi përshkrimin e dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale për të cilën janë në dijeni. Vërehet se raportimi i dyshimit të arsyeshëm lidhur me veprën penale praktikohet si raportim verbal nga hetuesit për Prokurorin e Shtetit. Kjo mënyrë e raportimit është jo e duhur, ngase lë hapësirë për devijim të informatave apo interpretimit jo të drejtë të rrethanave të rastit. Njëkohësisht mungesa e një raporti të shkruar për dyshimet për vepër penale mund të krijojë situata të ndryshme të keqkuptimeve gjatë përshkrimit të rasteve në mes këtyre dy palëve.

Rekomandimi nr. 4

IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, që të ushtrojnë mbikëqyrje më të rreptë në përmbushjen e obligimit ligjor të dalur nga neni 70, paragrafi 5 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit, Policia posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer vepër penale, brenda 24 orëve duhet t'i dërgoj raport Prokurorit kompetent të Shtetit, i cili më pas vendosë nëse duhet filluar procedura penale lidhur me rastin.

⁹ Dosjet nr. 2020-CA-1136, 2020-KE-37, 2020-KE-152, 2020-CF-1750 dhe 2020-CA-843.

3.2.9. Policia ka të hartuar formularët e nevojshëm të punës, të cilët janë të harmonizuar me aktet ligjore në fuqi dhe të njëjtit iu shërbejnë zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së veprimeve hetimore. Formularët janë të qasshëm për të gjithë zyrtarët policorë për t'u shërbyer me ta, me qëllim që të njëjtit t'i aplikojnë në veprimet e tyre policore. Gjatë analizimit të dosjeve hetimore, është vërejtur se formularët e përdorur brenda dosjeve hetimore janë unik në kuadër të Drejtorisë dhe ka një standard të caktuar të hartimit të tyre.

3.2.10. Secili vend ndërmerr hapa legjislativ dhe administrativ të domosdoshëm për të siguruar që të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantohen efektivisht. Gjatë ushtrimit të autorizimeve policore që rrjedhin si rezultat i detyrave dhe përgjegjësive të parapara me ligj, Policia luan rol me rëndësi në mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Bazuar në nenin 125 të KPP-së, në fillim të marrjes në pyetje në procedurë paraprake, hetuesi i autorizuar nga Prokurori i Shtetit, para marrjes në pyetje i lexon dëshmitarit apo të dyshuarit paralajmërimet mbi të drejtat e rezervuara nga ky Ligj dhe i njëjti duhet të konfirmoj me shkrim mbi të kuptuarit e të drejtave të lexuara nga intervistuesit (hetuesit). IPK ka vlerësuar respektimin e këtyre të drejtave në procedurën paraprake, gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarit dhe dëshmitarit. Në dosjet e kontrolluara, deklaratat kanë përmbajtur të drejtat e personave të intervistuar, mirëpo në disa raste në formularët e të intervistuarve, i intervistuari ka nënshkruar edhe në hapësirat ku është dashur të nënshkruaj zyrtari policor (intervistuesi). Hetuesit duhet treguar kujdes gjatë kompletimit të dosjes dhe vendosjes së nënshkrimit, ashtu siç parashihet në procesverbalet e të intervistuarve.

Rekomandimi nr. 5

IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit, në mënyrë që me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve apo të dyshuarve, të kenë kujdes që secila palë të nënshkruaj në vendin e caktuar brenda formularit.

3.2.11. IPK me rastin e kontrollimit të dosjeve hetimore, nëse ka hasur se lidhur me rastet ka pasur edhe persona të ndaluar, ka verifikuar edhe prezencën e aktvendimit mbi ndalimin e personit të arrestuar. IPK ka marrë Kodin e Procedurës Penale si kriter matës, konkretisht nenet që rregullojnë çështjet e arrestimit dhe ndalimit, si dhe PSO-në që trajton mënyrën e procedimit dhe unifikimin e formularëve. Në kuadër të këtij kriteri është vlerësuar aplikimi i formularëve mbi të drejtat e personit të arrestuar, si dhe prezenca e aktvendimit mbi ndalimin. IPK-ja ka gjetur që në të gjitha dosjet hetimore, në të cilat si pjesë e veprimeve hetimore ka qenë edhe kapja apo arrestimi i personave të dyshuar për vepër penale, zbatueshmëria dhe respektimi i këtyre të drejtave dhe vendimeve, ka qenë në nivel të mirë, duke përmbushur kështu standardet e kërkuara. IPK-ja çmon angazhimet e DHKEK-së në respektimin e procedurave të arrestim - ndalimit dhe të të drejtave të personave të privuar nga liria.

3.2.12. Veprimtaria e Policisë rreth zbulimit të veprës penale, gjetjes së kryesve dhe sigurimit të provave kurorëzohet me kallëzim penal që ky organ ia drejton Prokurorit të Shtetit. Në të shkruhen paraqiten provat e mbledhura dhe bashkë me të dorëzohen skicat, sendet, fotografitë, procesverbale të masave dhe veprimeve të kryera, si dhe materiale tjera që kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës. Forma e kallëzimit penal nuk është e paraparë me ligj, me qëllim që edhe qytetarët të kontribuojnë në zbulimin e veprave penale dhe kryesve pa ndonjë formalitet të veçantë. Mirëpo, kallëzimi penal është obligator për organet zbatuese të ligjit, nga fakti që detyrohen t'i paraqesin

veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare, për të cilat janë informuar apo janë në dijeni në një formë tjetër. Kallëzimet penale në kuadër të dosjeve hetimore, kanë qenë të hartuara në nivel të kënaqshëm, duke pasur të qartë se ndaj kujt ushtrohen, organit të cilit i drejtohet dhe veprimet e ndërmarra gjatë mbledhjes së informatave lidhur me veprën penale. Kallëzimet penale të ushtruara ndaj personave të dyshuar kanë qenë të nënshkruara nga mbikëqyrësit dhe zyrtarët policorë që i kanë ushtruar. IPK inkurajon hetuesit e DHKEK-së që në vazhdimësi të ngritin cilësinë e hartimit të kallëzimeve penale, si dhe shkresave të tjera si pjesë të dosjeve hetimore.

3.2.13. Policia heton veprat penale dhe të njëjtat ia raporton Prokurorit në kohën sa më të shpejtë të mundur. Bazuar në Procedurën Standarde të Operimit - Procedimi i lëndëve dhe kompetencat lëndore të hetimit (ZDPO/02/021/2013), paragrafi 5.6 (Procedimi i lëndëve - rasteve) parasheh që hetuesi, i cili është i ngarkuar me hetimin e rastit, fillimisht duhet ta plotësoj formën standarde për informim të Prokurorit kompetent, ta dërgoj tek Prokurori, pastaj në bashkëpunim të ngushtë me rreshterin/togerin e njësisë, duhet të bëjë një plan veprimi, sipas të cilit do të zhvillohet procesi i hetimit. Po ashtu, edhe PSO për Drejtorinë e Hetimit të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, në kapitullin IX (Detyrat dhe përgjegjësitë) përcakton në mesin e përgjegjësive dhe detyrave të hetuesit, edhe përpilimin dhe mbajtjen e azhurnuar të ditarit të hetimeve dhe planit hetimor. Sa i përket planit të veprimit, sipas të cilit do të zhvillohet procesi i hetimit për rastin, ky plan nuk ka ekzistuar në asnjërën prej dosjeve të kontrolluara¹⁰. Mungesa e planeve të veprimit në rastet e trajtuara vlerësohet rezultat i neglizhencës së personelit dhe menaxhmentit të njësive kompetente hetimore për hetimin e rasteve. Mosnxjerrja e planeve të veprimit mund të ketë efekte negative në kryerjen e mirë të detyrave dhe arritjes së rezultateve positive, drejt zbulimit të veprave penale dhe kapjes së kryesve të tyre.

Rekomandimi nr. 6

IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit e ngarkuar me raste penale, që të eliminohen dobësitë e identifikuara gjatë inspektimit që lidhen me mungesën e planeve të hetimit brenda rasteve të iniciuara.

3.2.14. I dyshuari ka të drejtë në mbrojtës gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, dhe para çdo marrjeje në pyetje të të dyshuarit, Policia e njofton atë për të drejtën në angazhimin e mbrojtësit. Nga e drejta në mbrojtës mund të hiqet dorë, përveç në rastet e mbrojtësit të detyruar, nëse heqja dorë bëhet e qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë mbi të drejtën në mbrojtje. Mbrojtja ligjore për fëmijët viktimë bëhet përshtatshëmrisht sipas nenit 63, paragrafi 1 dhe 2 të KPP. Nga kontrolli i dosjeve është vlerësuar respektimi i dispozitave ligjore në deklaratat e të dyshuarve në rastet ku prezenca e avokatit mbrojtës ka qenë e domosdoshme gjatë marrjes së deklaratës. Në të gjitha dosjet e kontrolluara është vlerësuar se dispozitat ligjore për të drejtën në mbrojtje janë zbatuar në harmoni me nenin 57 të KPP-së. IPK-ja çmon angazhimet e hetuesve në respektimin e këtyre dispozitave ligjore.

¹⁰ Dosjet nr. 2020-CA-1136, 2020-KE-37, 2020-KE-152, 2020-CF-1750, 2020-CA-843 dhe 2020-KE-105.

3.3. Administrimi i dosjeve penale

3.3.1. DHKEK administron numër të konsideruar të dosjeve me natyrë të ndjeshme penale. Sipas rregullave, dosjet e tilla është e nevojshme të mbahen në pronësi të fond-krijuesit (drejtorisë), deri në momentin kur konsiderohen si lëndë të përfunduara. Pas përmbylljes së kësaj periudhe që sipas rregullave është dy (2) vjeçare, dokumentet e tilla drejtohen në Arkivin¹¹ Qendror për ruajtje sipas afateve të ruajtjes të përcaktuar me Ligjin për Arkivat. Bazuar në Rregulloren për ruajtje dhe qasjen në dokumentacionin zyrtar¹², fond-krijuesi, i cili nuk e ka dorëzuar dokumentacionin për arkivim në Arkivin Qendror, por ende e ka nën mbikëqyrje të vet, është i obliguar që të sigurojë lokacion/hapësirë të mjaftueshme, pajisje dhe mjete të nevojshme për ruajtje dhe shfrytëzim të këtij dokumentacioni, të klasifikoj/sistemoj materialin arkivor dhe në vazhdimësi të përzgjedhë apo të ndajë dokumentacionin pavlerë, të mbajë materialin arkivor në gjendje të rregullt dhe ta ruajë nga dëmtimi për deri sa të dorëzohet në Arkivin Qendror. Dispozitat e Rregullores janë të obligueshme për njësitë policore, të cilat gjatë punës së tyre krijojnë dokumentacion zyrtar, i cili dërgohet për arkivim në arkivat policore. Me qëllim që të përcaktojë veprimet policore lidhur me trajtimin e duhur të dokumenteve zyrtare që kanë vlerë për arkivim, Policia ka përpiluar Procedurë Standarde të Operimit (DSHB-1.05) për Menaxhimin e Dokumenteve Arkivore, të cilës duhet t'i nënshtrohen për zbatim të gjitha drejtoritë hetimore. Kjo PSO përcakton mënyrën e ruajtjes, administrimit, mbrojtjes dhe qasjes së avancuar në këto dokumente.

3.3.2. IPK-ja ka inspektuar arkivin e dosjeve në DHKEK-së dhe ka parë nivelin e sigurisë, kushtet e ruajtjes dhe mënyrën e administrimit me dosje. Është bërë kontrolli i Dhomës së dosjeve për të parë mënyrën e trajtimit të dosjeve dhe kushtet nën të cilat ruhen ato. Dhoma nuk plotëson të gjitha standardet për arkivim të dosjeve. Ajo është e vendosur në hapësirë të adaptuar, e destinuar për dhoma pune dhe inventari i vendosur brenda saj nuk mundëson ruajtje, vendosje dhe sistemim në mënyrën e duhur të dokumenteve. Po ashtu, Dhoma e dosjeve nuk ofron sigurinë e duhur të lëndëve nga faktorët dëmtues. Inventari brenda saj plotëson kushtet e parapara nga aspekti fizik, por ka ngecie në masat e sigurisë për të ofruar kushte më të përshtatshme (ajrosja, lagështia, siguria ndaj zjarrit, etj.). Dera hyrëse është nga druri, e përforcuar me derë me grila metalike për të rritur nivelin e sigurisë. Hyrja dhe hapësira brenda Dhomës nuk monitorohet me sistem kamerash. Nuk ka pasur aparat për shuarjen e zjarrit. Raftet janë të punuara me mbajtëse metalike statike dhe hapësira brenda Dhomës për vendosjen e materialeve apo dosjeve ka qenë e mjaftueshme. Dhoma e dosjes tek hyrja ka aparat për fotokopje, ndërsa brenda hapësirës së saj është i vendosur edhe kompjuteri.

3.3.3. Dosjet fizike penale kanë qenë të sistemuar mirë, klasifikuar në bazë të viteve. Nuk është prezantuar Libër fizik që tregon përmbajtjen e dosjeve dhe vendin e sistemimit. Ekzistojnë librat për evidentim fizik të rasteve/lëndëve penale nga sektorët hetimor për rastet e iniciuara në kuadër të Drejtorisë. Në Dhomën e dosjeve nuk mbahet regjistër për evidentim të hyrje dhe daljeve të personave në këto hapësira. Inspektorët kanë verifikuar dosjet penale të proceduara në Prokuroritë kompetente gjatë vitit 2020 dhe është parë se janë të evidentuara në formë elektronike, përkatësisht të vendosura edhe në SIPK.

¹¹ Arkivi është hapësirë për administrim të dokumenteve, lëndëve, regjistrave, shkresave e materialeve tjera që duhet të ruhen në vende të posaçme që ofrojnë kushte për ruajtje dhe janë të organizuara sipas akteve ligjore në fuqi.

¹² Neni 5, paragrafi 3 i Rregullores nr. 13/2015 për ruajtjen dhe qasjen në dokumentacionin zyrtar.

4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbyllës të datës 26.05.2021, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit, që të sigurohet se janë ndarë qartë kompetencat lëndore të njësive rajonale në raport me sektorët tjerë qendror të Drejtorisë, në drejtim të eliminimit të paqartësive se kush duhet të merret me trajtimin e lëndëve dhe kjo minimizon situatat që Drejtorit t'i njihet ekskluziviteti në ndarjen e rasteve (lëndëve).	-1-	DHKEK, ka parasysh rekomandimin e IPK-së dhe do të reflektojë në raport me rekomandimin 1. dhe ruajtjes së baraspeshës funksionalitetit të supbordinimit brenda sektorëve dhe njësive në kuadër të drejtorisë.	Brenda gjashtë deri në 12 muaj. (Arsyetim: kjo PSO do të krijohet (ridizajnohet) nga një komision i veçantë)
2.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit, që në koordinim me Departamentin e Burimeve Njerëzore, të shqyrtojnë situatën aktuale me burimet e disponueshme dhe ato të nevojshme, në mënyrë që kërkesat për plotësimin e vendeve të punës të jenë të bazuara në Strukturën organizative, duke eliminuar mospërputhjet gradë-pozitë dhe sistemuar personelin konform nevojave.	-1-	Gjendja momentale e konstatuar nga ekipi inspektues i IPK-së, është e trashëguar ndër vite në DHKEK. Gjatë vitit 2021, kemi ndërmarr veprime (kërkesa) konkrete për plotësim të stafit, konkursi i shpallur është pezulluar.	Do t'i bëhet kërkesë shtesë (meqë kërkesa paraprake ka kaluar), grupit për strukturim në PK, për plotësimin e strukturës konformë gjendjes aktuale dhe nevojave që janë shfaqur për të kryer ushtrimin e detyrave në drejtim të hetimit të veprave penale sa më me efikasitet dhe efektivitet
3.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit, që të rishikoj politikat aktuale të	-1-	DHKEK, ndjekë thujtë të gjitha procedurat e paraqitura nga IPK. Mirëpo, do të ketë parasysh faktin që praktika e	Aplikimi praktik, në vijimësi.

	trajtimin të informatave, duke synuar ndryshimin - plotësimin e Procedurave Standarde të Operimit, në mënyrë që të rregullohet procedura mbi pranimin e palës, regjistrimin paraprak të tij dhe mbajtjen e shënimit zyrtar mbi rastin që raportohet.		zbatuar, të shfaqet në material (dokumentin) PSO, që ka ndërlidhje me rekomandimin 1.	Dokumenti (PSO-ja), sipas planit të veprimit nga rekomandimi 1.
4.	IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, që të ushtrojnë mbikëqyrje më të rreptë në përmbushjen e obligimit ligjor të dalur nga neni 70, paragrafi 5 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit, Policia posa të ketë dyshim të arsyeshëm se është kryer veprë penale, brenda 24 orëve duhet t'i dërgoj raport Prokurorit kompetent të Shtetit, i cili më pas vendosë nëse duhet filluar procedura penale lidhur me rastin.	-1-	DHKEK edhe në komunikim (takim) me Kryeprokurorin e PTH-së në Prishtinë, në fillim të vitit kalendarik, kemi vënë theksin tek Neni 70, paragrafi 1, të KPPRK-së. Mirëpo, gjithë sesi do t'i epet vëmendje konkrete rekomandimit përkatës të IPK-së	Menjëherë
5.	IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit, në mënyrë që me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarëve apo të dyshuarve, të kenë kujdes që secila palë të nënshkruaj në vendin e caktuar brenda formularit.	-2-	DHKEK, stafi menaxherial, do të ketë në fokus ditor, gjatë kryerjes së aktiviteteve hetimore, përdorimit të formularëve përkatës (të potencuar) që të evitojë këtë lëshim teknik.	Menjëherë
6.	IPK-ja u rekomandon Shefave të Sektorëve të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit e ngarkuar me raste penale, që të eliminohen dobësitë e identifikuar gjatë inspektimit që lidhen me mungesën e planeve të hetimit brenda rasteve të iniciuara.	-2-	DHKEK, do të ndërmarr aktivitete kontinue, përmes njoftimit, kontaktit direkt me hetuesit dhe përmes kontrollit që kjo në proces të jetë e përmbushur si veprim procedural.	3 muaj.